



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM



Nr. 386, datë 1.6.2022

PËR

**MIRATIMIN E FUSHAVE DHE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT,  
QË PËRBËJNË PRIORITET KOMBËTAR DHE MBËSHTETJEN  
FINANCIARE TË STUDENTËVE TË SHKËLQYER  
E STUDENTËVE, QË NDJEKIN KËTO PROGRAME  
NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 112, të ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar në institucionet publike të arsimit të lartë, përkatësisht, sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit ose të ardhura të tjera të ligjshme, për vitin akademik 2022 – 2023, e në vijim, të studentëve shtetas shqiptarë, të pranuar në institucionet publike të arsimit të lartë, që nuk janë njëkohësisht përfitues të ndonjë financimi tjetër nga shteti shqiptar dhe që plotësojnë kriteret e mëposhtme:
  - a) Studenti me notë mesatare në pranim që:
    - i. ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00;
    - ii. në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.5 deri në 10.00.
  - b) Studenti fitues i njërit prej tri çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare të arsimit parauniversitar, me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse, pavarësisht notës mesatare, kur pranohet në programe studimi, që lidhen me lëndën/t/disiplinën ku ka fituar çmimin;

- c) Studenti, i cili ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar dhe që ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare, jo më pak se 8.5, përfshirë notën e përshkallëzuar të provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore.
3. Mbështetjen financiare, vetëm për njëren nga kategoritë e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, e përfiton studenti për program të parë studimi dhe që pranon:
- a) të nënshkruajë marrëveshje, ndërmjet përfituesit të financimit apo përfaqësuesit ligjor të tij, institucionit të arsimit të lartë, ku pranohen për të kryer studimet, dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin, përfitimin e financimit në Republikën e Shqipërisë;
  - b) të punojë në profesionin për studimet e të cilit përfiton financim nga momenti që i lind e drejta për të punuar, bazuar në legjislacionin në fuqi, në sektorin shtetëror, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, për jo më pak se 3 (tre) vjet, përfshirë edhe rastin kur i ndërpritet financimi për shkak të mos përbushjes së kriterit të notës mesatare gjatë studimeve;
  - c) të kalojë zyrtarisht diplomën/at origjinale përkatëse të arsimit të lartë, për të cilin përfiton financim, nga institucioni publik i arsimit të lartë ku ka përfunduar studimet tek institucioni apo subjekti juridik ku punësohet, deri në shlyerjen e detyrimeve, sipas marrëveshjes së parashikuar në këtë vendim.
4. Studenti përfitues, me qëllim vijimin e financimit, duhet të ruajë notë mesatare, jo më pak se 9.5 gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve të ciklit të parë dhe të dytë ose gjatë ndjekjes së studimeve të integruese të ciklit të dytë në institucionin publik të arsimit të lartë dhe notë mesatare, jo më pak se 8.5 në programin e studimit, që përbën prioritet kombëtar në institucionin publik të arsimit të lartë.
5. Studenti përfitues ka detyrimin për të kthyer masën e financimit të përfituar në rast se:
- a) përjashtohet nga institucioni publik i arsimit të lartë;
  - b) ndërpërdit studimet, për të cilat është mbështetur financiarisht, pa miratimin e institucionit publik të arsimit të lartë dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin;
  - c) nuk ka përfunduar studimet në ciklin përkatës brenda 1 (një) viti, pas përfundimit të kohëzgjatjes normale të studimeve, me përjashtim të rasteve të sëmundjeve, të rasteve të fatkeqësive familjare apo kur parashikohet nga institucioni i arsimit të lartë, sipas përcaktimeve në marrëveshjen përkatëse të financimit.

6. Përzgjedhja e kandidatëve kryhet para fillimit të vitit akademik, mbi bazën e renditjes, sipas notës mesatare dhe fondit në dispozicion për vitin përkatës financiar. Në rast të dhënisë së donacioneve për këtë financim, në procedurën përzgjedhëse ka të drejtë të marrë pjesë edhe një përfaqësues i donatorit. Rregullat e hollësishme për afatet e aplikimit, shqyrtimit dhe procedurat për përcaktimin e masës dhe të mënyrës së financimit, për secilën nga kategoritë e parashikuara në këtë vendim, përcaktohen nga ministri përgjegjës për arsimin, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
7. Studentët përfitues, sipas këtij vendimi, depozitojnë në ministrinë përgjegjëse për arsimin listën e notave dhe vërtetimin për shlyerjen e të gjitha detyrimeve për vitin e parë dhe vijues të studimeve.
8. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas diplomimit, deri në përbushjen e detyrimit për punësim, përfituesit duhet të aplikojnë për çdo pozicion të lirë pune në institucionet e administratës buxhetore shtetërore dhe institucionet e pavarura publike. Në institucionet, në të cilat marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës, rekrutimi në pozicionet përkatëse i përfituesve kryhet me prioritet. Përfituesit, sipas këtij vendimi, punësohen nga Departamenti i Administratës Publike, në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, për gjithë kohëzgjatjen e detyrimit për punësim. Në rast mospunësimi deri në 6 (gjashtë) vite kalendarike nga dita e lindjes të së drejtës për punësim, studenti konsiderohet se i ka përbushur detyrimet sipas këtij vendimi dhe ka të drejtën e tërheqjes së diplomës origjinale nga institucioni publik i arsimit të lartë ku ka përfunduar studimet e finançuara, sipas këtij vendimi.
9. Studentët, të cilët kanë përfituar financim dhe nuk kanë realizuar detyrimet e programit përkatës dhe/ose i ndërpresin ato, sipas kushteve të përcaktuara në këtë vendim dhe në aktmarrëveshjen e lidhur ndërmjet përfituesit dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin, duhet t'i kthejnë ministrisë përgjegjëse për arsimin shumën e përfituar, brenda 6 (gjashtë) muajve nga dita e njoftimit nga ministria. Në rast të moskthimit të shumës apo refuzimit nga ana e përfituesit brenda këtij afati, ndiqen procedurat ligjore për zgjidhjen e çështjes, sipas legjislacionit në fuqi.
10. Studentët përfitues, të përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, përjashtohen nga pagesa e tarifës vjetore të shkollimit dhe financohen në nivelin e pagës minimale në shkallë vendi, për çdo muaj, përgjatë kohëzgjatjes së vitit akademik, pas konfirmimit të frekuentimit të programit përkatës të studimit nga institucioni publik i arsimit të lartë.

11. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

## K R Y E M I N I S T R I

### EDI RAMA


Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

MINISTRI I ARSIMIT  
DHE SPORTIT

EVIS KUSHI



## Shtojca nr. 1

Fushat e gjera të studimit	Fushat e detajuara të studimit	Programi i studimit
Arte dhe humanitaret	Gjuhë dhe letërsi	Gjuhë shqipe dhe letërsi Biologji Biologji-Kimi
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	Shkencat e mjedisit Kimi Fizikë Matematikë	Studime mjedisore Shkenca mjedisore Kimi Fizikë Matematikë Matematikë-Fizikë
Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	Teknologja e mbrojtjes së mjedisit Mjete motorike, anije dhe avionë Miniera dhe industri nxjerrëse	Inxhinieri Mjedisi Inxhinieri Navale Navigacion dhe menaxhim detar Inxhinieri e Burimeve Minerare Inxhinieri e Naftës dhe Gazit Inxhinieri Gjeoinformatike Inxhinieri Gjeologjike Inxhinieri Gjeomjedis
Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinari	Kultivim dhe prodhim	Inxhinieri agrare profil Mbrojtje bimësh Inxhinieri agrare profil Hortikulture Inxhinieri agrare profil Agronomi Inxhinieri agrare profil Agromekanizëm Zootekni dhe siguria e produkteve blegtoriale Biologji marine dhe akuakulturë Bioteknologji zooveterinare Agrobiologji Agrobiznes Agroushqim

		Vreshtari Enologji
		Inxhinieri Agronomike
	Pyje	Inxhinieri Pyjore
	Veterinari	Inxhinieri Përpunim Druri
		Mjekësi Veterinare
Shërbime	Turizëm	Menaxhim Turizmi (rural, arkeologjik, kulturor, hoteleri-restoran, mikpritje)
		Ekonomi-Turizëm
		Turizëm

NR.PROT. 3140/1  
DATË 6. 6. 2022

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT  
INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË  
LARTË  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

Engjell AGACI



The stamp is circular with the text "REPUBLIKAE SHQIPERISE" at the top and "KESHILLI I MINISTRAVE" at the bottom. In the center is a blue shield featuring a double-headed eagle with wings spread, holding a sword and a book.